

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ERIOL ROSHI

02/07/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 06.02.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Eriol Roshi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 07.02.2019 vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Eriol Roshi, kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Valbona Sanxhaktari relatore, z. Lulzim Hamitaj anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve .

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.